



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 74-të, të mbajtur më 06.09.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-4029/1 datë 20.10.2021, NDËRPRITET  
KSHPK-ja konstatoi se pretendimet në denoncim nuk ishin vërtetuar dhe nuk kishte elemente për veprime të mëtejshme.

Lënda me numër 12-4029 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-4029/1 të datës 20.10.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për shkelje të Kodit Zgjedhor gjatë Zgjedhjeve Lokale 2021 në Komunën ///, në kuptimin që drejtori i ///, personi zyrtar ///, në kundërshtim me ndalimet. të nenit 8-a të Kodit Zgjedhor, ka lidhur kontrata në vepër për një afat të caktuar me disa persona. Nga ana tjetër, këta persona, në zgjedhjet e ardhshme lokale 2021, sipas pretendimeve në denoncim, duhet të kishin votuar për kandidatin për kryetar të Komunës /// nga partia politike ///, ///, si dhe për kandidatët nga kjo parti politike për anëtarë të këshillit komunal. Thuhet se drejtori i lartpërmendur /// ishte aktivist i shquar i partisë politike ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së kërkesës, KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë për veprim kompetent nga Inspektorati Shtetëror i Punës i RMV-së, i cili pas inspektimit të jashtëzakonshëm ka raportuar se në të shënuar /// në muajt ///, ///, / /// dhe / /// 2021, ///, ///, /// dhe /// janë punësuar persona me kontratë në vepër pune, persona të cilët më parë kanë qenë të punësuar me zgjatje mujore të kontratave, pra nuk ka pasur kontrata të lidhur me persona të rinj gjatë asaj periudhe .

Në bazë të të gjeturave, KSHPK-ja konstatoi se pretendimet nga kërkesa janë të pabazuara, andaj vlerësoi se lënda nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm dhe vendosi si në dispozitiv të Vendimit.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: K.N.

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska

